



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.15/2018
Prishtinë, më 14.02.2018, në orën 12:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari - Lila, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Gani Dreshaj dhe Qëndron Kastrati, anëtarë.

I ftuara: Rasim Demiri, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

Pjesëmarrës të tjerë: Besim Kamberaj, Eldis Abazi dhe Lidon Pajaziti - MZHR, Rrahim Ramaj – BIRN, Dren Ajeti – KPK, Dardan Abazi – INDEP, Adelina Hasani – KDI, Anita Berisha, Arta Dehari dhe Berita Abazi – LVV.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;**
- 2.Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;**
- 3.Raportim i ministrit të Ministrisë për Zhvillim Rajonal, z. Rasim Demiri, lidhur me prioritetet e ministrisë;**
- 4. Të ndryshme;**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, kërkoi sqarime se a është sjellë përgjigja nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, lidhur me kërkesat e komisionit për ankesën e palës lidhur me konkursin për emërim në Bordin e ZRRE-së.

Memli Krasniqi tha se nuk ka qenë në kompetencën e komisionit tonë që vendosim për ankesa të tilla. Kërkoj që ta përfshijmë në rend të ditës, votimin e kandidatëve për Bordin e ZRRE-së, si pikë të parë për shqyrtim.

Hykmete Bajrami tha se nuk kemi dashur ta trajtojmë kërkesën, por shqetësimi ka qenë pse kandidati nuk ka marrë përgjigje në ankesën që e ka bërë.

Kryetarja: Konsideroj që është shumë e rëndësishme që të kompletohet Bordi i ZRRE-së dhe po ashtu, jam e bindur se çdonjëri nga ju kolegë deputetë është i interesuar që ky bord të kompletohet dhe të vazhdojë me punën e tij. Andaj, u pajtua që të shtohet në rend të ditës “Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr. 17/21 datë 22.12.2017 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë”.

Rendi i ditës u plotësua më propozimin e deputetit Memli Krasniqi.

2. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.17/21 datë 22.12.2017 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Kryetarja konstatoi se debati është shterur lidhur më këtë çështje edhe në mbledhjet e mëhershme, ftoj deputetët që të deklarohen më votë për “Vendimin e Qeverisë lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë”.

Komisioni, unanimisht, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Kuvendi të zgjedhë me votim të fshehtë 2 (dy) nga 4 (katër) të propozuarit e Qeverisë, për anëtar të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si vijon:

- 1.1. Bekim Jakupi,*
- 1.2. Fadil Ismajli,*
- 1.3. Izet Rushiti,*
- 1.4. Selman Hoti.*

2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare

Kryetarja ia kaloi fjalën kryesueses së grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, znj. Hykmete Bajrami.

Hykmete Bajrami, tha se pas opinioneneve pozitive të Komisioneve të përhershme, nuk me mbetet diçka për të shtuar përveçse t'i ftojë kolegët që të procedohet për seancë në lexim të dytë ky projektligj.

Komisioni, unanimisht, nxori këtë:

Rekomandim

- 1. I rekomandohet Kuvendit miratimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.*
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.*

4. Raportim i ministrit të Ministrisë për Zhvillim Rajonal, z. Rasim Demiri, lidhur me prioritetet e ministrisë

Kryetarja tha se komisioni në mbledhjen e kaluar ka marrë vendim për ta ftuar ministrin e Zhvillimit Rajonal, z. Rasim Demiri, për të raportuar lidhur me prioritetet e ministrisë.

Rasim Demiri, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, para komisionit paraqiti prioritetet e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, të realizuar në vitin 2017, si dhe prioritetet për vitin 2018. Si ministri e re, MZHR ka punuar në vitin 2017 në funksionalizimin e ministrisë, në hartimin e programeve dhe planeve për vitin 2018, si dhe për planifikimet e ardhshme. MZHR, bazuar në mandatin që ka për hartim të politikave për fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar, ka vendosur edhe prioritetet për këtë fushë, ku ndër prioritetet kryesore janë: Zhvillimi rajonal i balancuar në pesë rajonet ekonomike; Krijimi i vendeve të reja të punës përmes granteve; si dhe, Përmirësimi i infrastrukturës në komuna për zhvillim socio-ekonomik. Programi i Zhvillimit Rajonal i cili është lansuar këtë vit, i dedikohet komunave ku do të përkrahen projektet e investimeve kapitale të komunave që ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik dhe deri më tani janë pranuar rreth 6.5 mil € kërkesa për projekte. MZHR, gjithashtu ka lansuar edhe programin për zhvillim rajonal të balancuar, i cili do të përkrah projektet e bizneseve të cilat gjenerojnë vende të reja pune në gjithë territorin e Kosovës. Me qëllim që të pasqyrojë një zhvillim të balancuar, MZHR do të planifikon, zhvillon treguesit dhe do të përgatit analiza për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar, të cilat do t'i paraqiten Qeverisë edhe me raporte përkatëse.

Dardan Molliqaj tha se këto rajone ekonomike, a do të koncentrohen investimet sipas rajonit me pak të zhvilluara apo edhe që këto investime të jenë të përshtatshme specifikisht për rajonin e caktuar? Ku do të jenë të orientuara grantet, në cilat lloje të bizneseve? Sugjerim i imi do të ishte ndarja e granteve të jetë e tillë, që të jetë e përshtatshme për rajonin ku jepen ato.

Hykmete Bajrami, pyeti ministrin se a keni problem dhe a jeni të dakorduar me Ministrinë e Pushtetit Lokal në ndarjen e granteve? Ju nuk keni raporte nga terreni sepse jeni ministri e re, si do të identifikoni zonat me pak të zhvilluara? Si do të ndani këto mjete për grante? Dhe po ashtu, do doja të kisha informacion për formimin e dikastereve brenda ministrisë.

Mimoza Kusari – Lila: Ju thatë se keni pasur kërkesë për 6.5 milionë euro, për investime për projekte të përbashkëta, a ka mundësi të na tregoni se cilat komuna bashkërisht kanë aplikuar në ministri për këto projekte? Me intereson të dijë së në raport me përgatitjen e kriterëve, cili ka qenë koordinimi i juaj me ministrinë të cilat janë angazhuar në këtë formë të asistimit të bizneseve. Nga programi i Qeverisë dhe buxheti i Kosovës, kemi parë së Ministria e Inovacionit; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Ministria e Juaj dhe Ministria e Bujqësisë, ka skema të garantëve, pra, kriteret që ju keni përpiluar a kanë ndonjë koordinim në çfarëdo natyre apo përmes mekanizmave, siç është Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik ose ndonjë mekanizëm tjetër. Që të shihet se si dhe cilat biznese të targëtohen, sepse mund të jenë shumë lehtë përfitues të këtyre garantëve biznese të njëjta. Ndërsa, në kriteret e juaja, në veçanti për komunat ose rajonet me pak të zhvilluara, a keni paraparë kriter gjinor, a keni paraparë ndonjë përparësi për bizneset e grave ose të vendosni ndonjë kuotë gjinore për përfitim të këtyre granteve?

Dardan Sejdiu: Dua të ndërlihem në dy gjëra, që ju potencuat, njëra është zvogëlimi i pabarazisë në zhvillim të rajoneve që ju i keni ndarë në 5 (pesë) dhe krijimi i vendeve të reja të punës. Nga 2 (dy) milionë euro që i keni paraparë për infrastrukturë të këtyre rajoneve, cilat do të jenë përfitimet numerike në vogëlimin e zhvillimeve rajonale. Më intereson ta dijë se si do ta ndryshojnë gjendjen e zhvillimit rajonal këto investime, dhe e dyta dëshiroj të di sa vende të punës do të krijohen me këto fonde që keni ndarë për grante ose më thjesht sa do të kushtojë një vend i punës më këto grante.

Adem Hoxha i dëshiroj sukses ministrit dhe mirëseardhje në komision, dhe tha se i vjen mirë që sot edhe ju vendosni kufjet kur dikush përkthen e nuk e kuptoni atë që e thotë. Duke pasur parasysh që i thatë 5 (pesë) rajone, dhe që do të këtë diskriminim pozitiv të atyre rajoneve dhe kur flitni për vizitën në Dragash, nuk e di a keni thirrur ndokënd nga komunitet pakicë atje, duke pasur parasysh se në Dragash shumica janë shqiptarë, pastaj nga komuniteti boshnjak dhe goran. Nga planifikimet tuaja që keni bërë edhe ne do të ju ndihmojmë dhe shpresoj të kemi edhe mirëkuptimin edhe të deputeteve të tjerë.

Duda Balje: Më vjen mirë që kjo ministri do të jetë një mundësi e mirë për përfitime të granteve nga ana qytetarëve, e sidomos nga ata të Prizrenit, të cilët janë shumë të interesuar. I dëshiroj suksese në punë ministrit dhe i afrojmë mbështetje.

Kryetarja: Besojmë se kjo ministri do të zbuti pabarazinë e zhvillimit në mes të rajoneve, për ne, si deputetë, nuk besoj që ka rëndësi a dëgjohemi me kufje apo jo, por e rëndësishme është që të kemi bashkëpunim në të mirë të vendit dhe qytetarëve tonë.

Rasim Demiri, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal: Mendoj se pyetjet tuaja për ne janë si sugjerim për punën tonë të mëtejme, duke pasur parasysh se isha edhe deputet në legjislaturat e kaluara, ku edhe pyetjet e mira kanë qenë qëllim-mira e jo qëllim-keqë dhe të marr me tepër si ndihmë dhe sugjerim nga deputetët. Të gjithë jeni pajtuar që ministria është e re dhe çdo sugjerim i juaji për ne është i pranueshëm që të zhvillohemi si ministri. Sa i përket vendeve të punës, pra sipas programit që kemi 1 milion e 500 mijë euro, do të krijonte 500 deri në 600 vende të reja pune. Ne jemi munduar që të jenë të përfshira të gjitha komunitetet. Sa i përket vizitës time në Dragash, unë takimin e kam zhvilluar me kryetarin, por debati është zhvilluar

nga Agjencia për Zhvillim Rajonal, janë ftuar të gjithë qytetarët e Gorës. Kur është në pyetje balancimi i zhvillimit rajonal, ne jemi të vetëdijshëm për buxhetin komunal, më herët ka qenë kryetari i Hanit të Elezit dhe ai është ankuar se është i lenë anash dhe pa përkrahje! Ne dëshirojmë të vendosim një balancë dhe këtë po mundohemi ta bëjmë.

Dardan Sejdiu: Meqë po i trajtoni si sugjerime, unë po i parashtoj si pyetje, për këto 4 muaj të qeverisjes, sa takime keni pasur me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Investimeve Strategjike? Më intereson ta dijtë se a keni pasur takime me këto ministri, ku secila nga to pretendon të ulë numrin e papunësisë dhe ta rrisë zhvillimin ekonomik. Cilat kanë qenë temat që keni diskutuar mes vete, gjithnjë për koordinim politikash?

Rasim Demiri, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, tha: Zyrtarisht nuk kemi pasur takime të tilla, dhe ajo që desha të them paraprakisht, është se ministria jonë nuk përzihet në kompetencat e ministrive të tjera.

Dardan Sejdiu: Ne, si deputetë, jemi të obliguar që të sigurohemi që politikat që shtyhen përpara si Qeveri e kësaj Republike, të jenë në përputhje me bindjet që kemi rreth kësaj shoqërie dhe kësaj Republike. Çka është tepër problematike kur kemi 8 (tetë) ministri të cilat merren me zhvillim ekonomik, e zhvillimi ekonomik nënkupton vende të reja pune, ndërsa, ne jemi vendi me papunësinë më të lartë. Nëse këto 8 (tetë) ministri që thirren në zhvillim ekonomik nuk takohen asnjëherë mes vete, kjo është për t' u brengosur. Mendoj se nuk duhet të ekzistojnë me shumë së 3 (tri) ministri që merren me zhvillim ekonomik. Pyetja është, a ka ndonjë ministri tjetër që ndan fonde për grante bizneseve të cilat po fillojnë tash pra "start up", dhe nëse po, a ka mundësi të tregoni se cili është dallimi në mes të granteve që ju po i jepni dhe granteve që po japin ata?

Besim Kamberi, Ministria e Zhvillimit Rajonal, tha: Kjo ministri është e themeluar në fund të vitit 2017 dhe ne sigurisht që do të bëjmë analiza dhe do të marrin një pasqyrë së cili rajon është me pak i zhvilluar në mënyrë që ne t'i rekomandojmë qeverisë për investime apo grante. Aktualisht asnjëra ministri, e cila ka qoftë investime kapitale apo grante nuk ka ndonjë kursim të caktuar për të investuar në ndonjë rajon apo në ndonjë komunë të caktuar. Se ku janë të fokusuar grantet, ne kemi diskualifikuar disa fusha që mendojmë se kanë mundur të prekin kompetencat e ministrive të tjera, pra është diskualifikuar bujqësia, tregtia dhe ndërtimtaria, por sektorët e tjerë, i kemi lënë të hapur dhe jemi munduar të japim mundësi për bizneset e reja dhe ndërmarrësit e rinj. Koordinimi me ministrinë e tjera, sa i përket granteve ne kemi zhvilluar një takim edhe më kryetarët e komunave, ku kemi prezantuar skemat për dy programet tona që i kemi paraparë për vitin 2018. Sa i përket formimit të dikastereve të brendshme në këtë javë përfundon edhe diskutimi publik për rregulloren e brendshme të ministrisë tonë dhe tek në muajin e ardhshëm do të mund të fillojmë me rekrutim të stafit, kryesisht stafi është një pjesë që është bartur nga Ministria e Pushteti Lokal. Sa i përket hartimit të kriterëve për grante jemi koordinuar me 5 (pesë) agjencitë rajonale zhvillimore. Kurse, sa i përket asaj se sa kërkesa janë nga komunat për grante, kemi marrë 40 kërkesa nga komunat ku nga ato kemi aplikime të komunave të vetme dhe aplikime nga dy e me shumë komuna se bashku. Më këtë skemë synojmë të krijojmë 500 vende të reja pune, me skemën e subvencioneve, me rreth 187 përfitues të grantëve. Sa i përket asaj se edhe ministrinë e tjera kanë skema të granteve, unë përmenda që

kemi larguar skemat nga bujqësia, tregtia dhe ndërtimtaria, kurse, Ministria e Inovacionit, ka skemë, por ende nuk ka diçka të publikuar që të shohim ne se a kemi skema të njëjta apo jo.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do të ftojë ministrin e Zhvillimit Rajonal që të raportojë për secilën çështje në interes të komisionit, dhe i njëjti do t'i ofrojë komisionit raportet dhe materialet që i kërkohen.

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Dardan Sejdiu: Kërkoj që si komision t'i paraqesim kërkesën Sekretarit, që të na sigurojë një zyre të përbashkët për anëtarët e këtij komisioni.

Propozimi u përkrah nga komisioni.

Kryetarja i njoftoi për kërkesën që ka bërë OJQ PIPS për të zhvilluar një takim me anëtarët e komisionit lidhur me projektin e tyre për efikasitet të energjisë. Andaj, kërkoi nga komisioni që në një të ardhme të afërt ta presin këtë organizatë në takim.

Propozimi u përkrah nga komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

**E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,
Sala BERISHA SHALA**